



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Komuna e Glllogocit
Zyra e Kryetarit



01-Nr - 020/12 - 4628 dt. 29/08/2022

Në mbështetje të neneve 13 dhe 58 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqverisjen Lokale, Ligjit Nr.08/L-011 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr.04/L-061 për shitjen e banesave për të cilat ekziston e drejta banesore, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr.04/L-247, nenin 72 të Statutit të Komunës së Glllogocit 01-Nr.110-6904 të datës 24.09.2008, vendimit Nr.3234 datë 03.06.2022 të Ministrit të Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, Kryetari i Komunës, nxjerr:

VENDIM

PËR FORMIMIN E KOMISIONIT PËR SHQYRTIMIN E KËRKESAVE PËR SHITJEN E BANESAVE PËR TË CILAT EKZISTON E DREJTA BANESORE

I. Formohet Komisioni për shqyrtimin e kërkesave për shitjen e banesave për të cilat ekziston e drejta banesore, në këtë përbërje:

1. Besart Bajrami, kryetar i komisionit
2. Flora Thaqi, anëtar i komisionit
3. Granit Hasanaj, anëtar i komisionit

II. Komisioni për zbatimin e dispozitave të Ligjit Nr.04/L-061 për shitjen e banesave për të cilat ekziston e drejta banesore dhe dispozitave të Ligjit Nr.08/L-011 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr.04/L-247 për shitjen e banesave për të cilat ekziston e drejta banesore, autorizohet si vijon:

1. Shqyrton kërkesat e bartësve të së drejtës banesore për banesat të cilat dhënës i banesave janë institucionet publike lokale si dhe për banesat për të cilat është vërtetuar se shitësi i tyre është i panjohur, të drejtën e shitjes e bartë komuna në territorin e së cilës ndodhet banesa.
2. Njofton bartësit e të drejtës banesore përkatësisht shfrytëzuesit e banesave për të drejtën për blerjen e banesës dhe kompletimin e dokumentacionit i cili duhet t'i bashkëngjitet kërkesës nga pala në pajtim me Ligjin.
3. Pas procesit të shqyrtimit të kërkesave nxjerr vendim lidhur me kërkesat e aprovuara dhe përgatit kontratën e shitblerjes në pajtim me Ligjin.

III. Ky vendim hyn në fuqi, ditën e nënshkrimit nga ana e Kryetarit të Komunës.



Kryetari i Komunës

Ramiz Lladrovci

Vendimi i'u dërgohet:

- Zyrës së Kryetarit;
- Anëtareve të komisionit për shqyrtimin e kërkesave për shitjen e banesave për të cilat ekziston e drejta banesore;
- Drejtorisë për Planifikim Urban dhe Mbrojtje të Mjedisit;
- Arkivit;